

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë



Kush jemi ne

Misioni i OSBE-së punon për ta përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve, qeverisjen e mirë dhe standardet e sigurisë publike në Kosovë. I themeluar në vitin 1999, ky është Misioni i dytë i OSBE-së në terren për nga madhësia.

Është organizata e vetme civile ndërkombëtare e pranishme në mbarë Kosovën që i monitoron për së afërmi zhvillimet politike, institucionale dhe të sigurisë, dhe ofron mjete për përmirësime sistematike kurdo që është e nevojshme.



Misioni monitoron sektorin e drejtësisë në Kosovë dhe vlerëson përputhshmërinë e tij me standardet ndërkombëtare për të drejta të njeriut dhe për gjykim të drejtë, duke ofruar asistencë dhe trajnime sipas nevojës.

Njëra nga objektivat kryesore të Misionit është zhvillimi i mëtutjeshëm i shoqërisë demokratike dhe shumë-etnike në Kosovë, ku respektohen të drejtat e secilit. Në këtë aspekt, Misioni ofron ekspertizë dhe këshilla për institucionet në Kosovë dhe bashkëpunon me komunitetet, me qëllim të realizimit të mandatit të tij.

Misioni ka qenë i përfshirë në themelimin e një numri institucioneve kryesore, përfshirë në mesin e shumë tjerave, Kuvendin e Kosovës, Institucionin e Avokatit të Popullit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, organet komunale për mbrojtje të komuniteteve.

Misioni i ruan marrëdhëniet e ngushta të punës me të gjitha komunitetet dhe institucionet lokale, dhe është avokues i fuqishëm për komunitetet lokale në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.



Misioni punon për ta bërë barazinë gjinore realitet në Kosovë. Në një tryezë avokimi me qëllim promovimin e përfshirjes dhe avancimit të gruas në sektorin e sigurisë publike, OSBE ka bashkuar forcat me Shoqatën e Grave të Policisë së Kosovës.

Prania

Prania e Misionit në terren përbëhet nga pesë qendra/ zyra rajonale në Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren – si dhe 30 ekipe komunale nëpër komuna në tërë Kosovën.

Mandati

Mandati i Misionit, i përcaktuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Vendimin e Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 305 të datës 1 korrik 1999, i jep Misionit “rol udhëheqës në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve, demokracisë dhe të drejtat e njeriut.”

Misioni i OSBE-së në Kosovë është i angazhuar në tri fusha kryesore: të drejtat e njeriut dhe komuniteteve, demokratizimi dhe siguria publike. Misioni punon ngushtë me praninë e OSBE-së në terren në Evropën Juglindore për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal, dialogun dhe pajtimin.

Çka bëjmë ne

Aktivitetet e Misionit udhëhiqen nga katër parime: integrimi i perspektivave të shumë-etnicitetit, tolerancës dhe pajtimit; promovimi i transparencës dhe llogaridhënies për luftimin e diskriminimit; qëndrueshmëria; dhe integrimi gjinor. Ato janë esenciale për arritjen e një shoqërie prosperuese dhe demokratike.

Misioni i ka tri departamente programatike: Departamentin për të Drejta të njeriut dhe komunitete, Departamentin e Demokratizimit dhe Departamentin e Sigurisë e rendit publik.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe komuniteteve në Kosovë janë ndër objektivat kryesore të Misionit.

Për sa i përket të drejtave të komuniteteve, Misioni angazhohet në çështjet si pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje, siguria, të drejtat gjuhësore, kthimi dhe adresimi i problemeve tjera të zhvendosjes, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, dhe të drejtat pronësore.

Misioni është akteri kryesor ndërkombëtar për sa i përket monitorimit të sistemit të drejtësisë, me fokus në të drejtat e njeriut.

Raportet e rregullta tematike ofrojnë rekomandime konkrete dhe masa përcjellëse për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Raportet shfrytëzohen nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, i themeluar nga OSBE-ja, për zhvillim të mëturësishëm të trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë.

Si anëtar i Këshillit për Zbatim dhe Monitorim, mekanizëm i krijuar me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë, Misioni punon me partnerët për sigurimin e një mbrojtje më të mirë të Zonave të veçanta përreth objekteve dhe vendeve të trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Misioni promovon edhe tolerancën duke organizuar forume të dialogut ndërfaqësor ku përfshihen rinia dhe përfaqësuesit e të gjitha bashkësive dhe institucioneve fetare.

Demokratizimi dhe qeverisja e mirë

Misioni i OSBE-së angazhohet për forcimin e institucioneve demokratike transparente dhe llogaridhënese në Kosovë.

Aktualisht Misioni është duke ndihmuar Kuvendin e Kosovës në forcimin e marrëdhënies së tij me qeverinë për përmirësimin e planifikimit legjislativ dhe rritjen e llogaridhënies së ekzekutivit. Misioni ka mbështetur Kuvendin edhe në forcimin e marrëdhënies me shoqërinë civile.

Në nivel lokal, Misioni monitoron dhe mbështetë punën e institucioneve lokale në fusha të caktuara të politikave që ndërlidhen me përfshirjen, transparencën dhe llogaridhënien, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve që i ofrojnë ato për të gjitha komunitetet.

Rritja e standardeve për media të lira dhe profesionale në Kosovë është gjithashtu njëra nga objektivat e Misionit. Misioni, në pajtim me praktikën më të mira ndërkombëtare, punon për gjetjen e zgjidhjes afatgjatë të financimit të pavarur për RTK-në. Misioni bën edhe trajnimin e gazetarëve – përfshirë atyre nga komunat veriore – për raportim të ndjeshëm ndaj konfliktit, promovon programe rajonale të shkëmbimit për gazetarë, dhe punon me media për ta forcuar pavarësinë e raportimit dhe sigurinë e gazetarëve.

Misioni vazhdon t'i përkrah grupet për të drejtat e grave me fokus në ndalimin e dhunës së bazuar në gjini, dhe është aktiv edhe në punën me rininë përmes programeve të punës praktike në institucionet qeveritare.



Vetëdijesimi i rinisë rreth vlerave të OSBE-së është prioritet i Misionit. Në një turne basketbolli për juniorë të organizuar në Prishtinë nga Misioni i OSBE-së, të rinj nga komunitete të ndryshme mësuuan për të drejtat e njeriut dhe tolerancën duke marrë pjesë në sport.

Çka bëjmë ne

(vazhdim)

Siguria dhe rendi publik

Misioni ndihmon ministrinë dhe agjencitë për zbatimin e ligjit që t'i rishikojnë strategjitë dhe planet e veprimit për luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, krimit kibernetik dhe narkotikëve; si dhe strategjitë për policimin e udhëhequr nga inteligjenca, policimin në komunitet dhe sigurinë.

Për të përkrahur dialogun ndërmjet komuniteteve dhe policisë, Misioni punon në zgjerimin e partneritetit ndërmjet policisë dhe publikut. I ka themeluar një numër të forumeve të sigurisë në

bashkësi për trajtimin e çështjeve lokale të sigurisë dhe rendit dhe aktualisht është duke punuar për krijimin e forumeve të reja në veriun e Kosovës.

Misioni ofron përkrahje për rritjen e përqindjes së komuniteteve të nën-përfaqësuar dhe grave në radhët e policisë dhe pozitat udhëheqëse përmes vetëdijesimit dhe avokimit.

Misioni e monitoron edhe respektimin e standardeve ligjeve të drejtave të njeriut për përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe promovimin e reagimit të duhur policor në rastet e krimeve të urrejtjes.



Edhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm është fushë ku përqendrohet puna e Misionit. Përveç mbështetjes për zhvillimin e Strategjisë së Kosovës për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, Misioni ndihmon në zbatimin e saj. Misioni merr pjesë aktive në fushatën e OSBE-së të Bashkuar në Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (#UnitedCVE).


Fakte dhe shifra

Shefi i Misionit



Ambasadori Jan Braathu

Personeli



504 pozita, të përbëra nga 117 punonjës ndërkombëtar dhe 504 vendor. Personeli i Misionit është i vendosur në Selinë e OSBE-së në Prishtinë dhe në pesë qendra rajonale në mbarë Kosovën.

Buxheti



17,414,300 Euro

Ndiqni OSCE



Misioni i OSBE-së në Kosovë

Zyra për Çështje Politike dhe Komunikim
Departamenti i Shefit të Misionit
Abdyl Frashëri, 37
10000 Prishtinë

Tel: +381 38 240 100 lokali. 1118

E-mail: press.omik@osce.org

www.osce.org/kosovo

[@oscekosovo](https://twitter.com/oscekosovo)